



BANK OF ALBANIA

# Forumi Financiar IV Shqipëri

## Rigjallërimi i rritjes së kreditimit

***Gent SEJKO***

***Guvernator***

***Banka e Shqipërisë***

**1. Perspektiva makroekonomike**

**2. Rritja e kreditimit në Shqipëri**

**3. Përfundime**

# 1. Perspektiva makroekonomike


# 1. Perspektiva makroekonomike

## Ekonomia po rimëkëmbet




BANK OF ALBANIA

Rritja ekonomike dhe Inflacioni mesatar  
vitet 2009 - 2015



Rritja reale e PBB (%)



- **Kriza ekonomike globale pati ndikimet e saj mbi ekonominë dhe sistemin financiar në Shqipëri. Megjithatë:**

- Shqipëria nuk ra në recesion
- Shqipëria e ruajti stabilitetin ekonomik dhe financiar
- Shqipëria pati ecuri më të mirë se shumë prej vendeve të ngjashme në rajon

- **Rimëkëmbja pritet të forcohet në periudhën afatmesme:**




- Kërkesa e brendshme private pritet të udhëheqë rritjen e PBB-së në afat të shkurtër dhe të mesëm
- Rritja e eksporteve pritet të japë stimul shtesë në afat të gjatë

# 1. Perspektiva makroekonomike

Rimëkëmbja mbështetet në: (i) balanca financiare dhe ekonomike solide...



BANK OF ALBANIA



- **Konsolidimi i vazhdueshëm fiskal:**

- Ul primet e rrezikut sovran
- Lehtëson financimin e sektorit privat

- **Pozicioni i jashtëm i qëndrueshëm:**

- Redukton luhatshmëritë ekonomike dhe financiare
- Zbut rrezikun e perceptuar për investitorët e huaj

- **Rënia e kredive me probleme:**



- Reflekton përmirësimet në aktivitetin ekonomik dhe nismat e politikave për trajtimin e kredive me probleme (NPL)
- Përmirëson perceptimin e rrezikut dhe nxit ndërmarrjen e rrezikut në sistemin bankar

# 1. Perspektiva makroekonomike

... (ii) kushte financimi të qëndrueshme dhe në përmirësim...



BANK OF ALBANIA



- **BSH-ja është e angazhuar në një politikë monetare lehtësuese, nëpërmjet:**


- Uljes së normës bazë
- Rritjes së injektimit të likuiditetit
- Komunikimit të drejtimit të pritshëm të politikës monetare

- **Politika jonë monetare është pasqyruar në përmirësim të kushteve të financimit:**

- Kosto më të ulëta financimi për sistemin bankar
- Kosto më të ulëta financimi për sektorin privat
- Kosto më të ulëta financimi për sektorin publik



# 1. Perspektiva makroekonomike

... (iii) flukset hyrëse të IHD-ve dhe reforma strukturore të vazhdueshme



- **Flukset hyrëse të IHD-ve do të vazhdojnë të mbështesin rritjen:**

- Projektet TAP dhe Statkraft do t'i përshpejtojnë flukset hyrëse të IHD-ve në afatin e mesëm



- **Reformat strukturore të një spektri të gjerë të nevojshme për nxitjen e investimeve të brendshme dhe të huaja:**

- Forcojnë më tej stabilitetin ekonomik dhe financiar
- Përmirësojnë mjedisin e biznesit dhe ulin informalitetin
- Zhvillojnë infrastrukturën dhe rrisin kapacitetet e burimeve njerëzore

# 1. Perspektiva makroekonomike

## Megjithatë, disa sfida mbeten:



- Mjedisi i jashtëm vijon i vështirë:
  - Ekonomitë e partnerëve tanë tregtare vijojnë të përjetojnë rritje të plogësht
  - Rënia e çmimeve të lëndëve bazë dekurajon një pjesë të madhe të eksporteve tona tradicionale
  - Sjellja e mjedisit të jashtëm financiar mbetet kundër ndërmarrjes së rrezikut
- Ristrukturimi ekonomik dhe konsolidimi fiskal pengojnë rritjen në afat të shkurtër dhe të mesëm
- Reformat strukturore duhet t'i përshpejtojnë ritmet, pavarësisht nga kostot afatshkurtra që i shoqërojnë
- **Mungesa e mbështetjes me kredi mund të pengojë rritjen ekonomike!**






**BANK OF ALBANIA**

## **2. Rritja e kreditimit në Shqipëri**

## 2. Rritja e kreditimit në Shqipëri


Dinamika e rritjes së kreditimit u ndikua nga kriza financiare globale.



- **Shqipëria përjetoi rritje të shpejtë të kreditimit deri në vitin 2008, si rrjedhojë e:**
  - kërkesës së lartë për kredi (rritje e shpejtë e PBB-së dhe depërtim i ulët i kreditimit para krizës)
  - ofertës lehtësuese për kredi (sistem bankar likuid dhe konkurrues, politika zgjerimi nga bankat mëmë)
- **Ngadalësim i theksuar i kreditimit pas vitit 2008 (në veçanti pas 2011)**

## 2. Rritja e kreditimit në Shqipëri

Të kuptojmë ngadalësimin e kreditimit: A është maturuar cikli i kreditimit?



- **Trajektorja e ulët e rritjes së kreditimit nuk është në linjë me parimet tona themelore:**
  - Pa kreditim të mjaftueshëm, rimëkëmbja ekonomike nuk mund të zgjasë për shumë kohë
  - Ndonëse në përmirësim, raportet e kredisë ndaj PBB-së mbeten larg mesatares rajonale
  - Ristrukturimi ekonomik në vijimësi duhet të ofrojë mundësi të shumta kreditimi

## 2. Rritja e kreditimit në Shqipëri

Të kuptojmë ngadalësimin e kreditimit: A qëndron problemi nga ana e kërkesës apo e ofertës?

- **Faktorë nga ana e kërkesës:**

- Rritja e PBB-së u ngadalësua
- Mbifinancim në sektorë të caktuar të ekonomisë (p.sh. ndërtimi)

- **Faktorë nga ana e ofertës:**




- Rreziku i kredisë u rrit teksa kreditë me probleme (NPL) filluan të akumulohen
- Mjedisi i jashtëm (BE) financiar mbetet sfidues
  - Rregullimi bankar në BE është shtrënguar
  - Kapitali bankar mbetet sa i pamjaftueshëm edhe i kushtueshëm në BE
  - Në Shqipëri, ndodhi ulje e levës financiare/ristrukturim i bilancit, në një masë të caktuar

- **Megjithatë:**

- Faktorët nga ana e ofertës janë më të shumtë se faktorët e kërkesës
- Faktorët nga ana e kërkesës pritet të përmirësohen në afatin e mesëm.
- Nëse nuk përmirësohet, oferta e dobët për kredi mund të vërë në rrezik rritjen e kreditimit dhe rimëkëmbjen ekonomike

## 2. Rritja e kreditimit në Shqipëri

### Të kuptojmë ofertën e kredisë: Pse janë më të shtrënguara kushtet e kreditimit?



- **Rezultatet e Vrojimit të Aktivitetit Kreditues tregojnë**
  - Ndonëse në përmirësim, standardet e kreditimit për bizneset janë më të shtrënguara
  - Standardet e kreditimit për individët janë më të lehtësuara krahasuar me periudhën para 2008
  - Bankat duket të bëjnë dallime në bazë të profilit të rrezikut sipas sektorit dhe klientit
- **Normat e interesit të kredisë në Shqipëri janë ndër më të ulëtat në rajon**
- **Kushtet e kreditimit duket të mos jenë shtrënguar për:**
  - Shumën e kredisë
  - Komisionet
  - Afatin e maturimit
- **Bankat duket të kenë shtrënguar kreditimin duke aplikuar:**
  - Spread-e më të larta për kreditë me më shumë rrezik
  - Raporte më të larta KNV/mbulim më i madh me kolateral

## 2. Rritja e kreditimit në Shqipëri

### Veprimet e ndërmarra nga BSH-ja për rigjallërimin e rritjes së kreditimit



### BSH-ja ka adresuar si anën e kërkesës ashtu edhe të ofertës në ekuacion!

- **Nga ana e kërkesës:**

- Politika monetare lehtësuese synon të nxisë konsumin, investimet dhe kërkesën për kredi

- **Nga ana e ofertës:**

- Rregullimi prudencial ka synuar ruajtjen e stabilitetit financiar
- Janë përditësuar rregullore që kanë lidhje me kreditimin
  - Nxisin ristrukturimin e hershëm të kredisë
  - Fusin konceptin e fshirjes së detyrueshme të kredive
  - Kontrollojnë rrezikun nga Pasuri të tjera paluajtshme në pronësi (PP përfundojnë në bilancet e bankave)
- Janë aplikuar instrumente makroprudenciale kundërciklike
  - Është aplikuar peshë e ulët rreziku për rritjen vjetore të kredisë brenda intervalit 4-10%
  - Dekurajimi i flukseve dalëse të kapitalit dhe ulja e peshës relative të rrezikut për kreditimin e ekonomisë vendase
- Në bashkërendim me autoritete të tjera, janë mbështetur veprime për uljen e rrezikut të kredisë dhe përmirësimin e ekzekutimit të kolateralit, nëpërmjet:
  - Përmirësimeve në Kodin e Procedurës Civile
  - Përmirësimit të legjislacionit tatimor

## 2. Rritja e kreditimit në Shqipëri

Çfarë mund të bëjnë bankat tregtare për të mbështetur rritjen e kreditimit?



- **Të forcojnë bashkëpunimin dhe të përmirësojnë partneritetin me bizneset lokale**
  - Të kërkojnë në mënyrë aktive raste të mundshme të kreditimit të shëndetshëm
  - T'i përshtatin produktet e kredidhënies (dhe bankare) sipas profilit specifik të rrezikut të biznesit/sektorit/vendit
  - Të nxisin ristrukturimin e hershëm për bizneset produktive, mbështetur në udhëzime të qarta dhe transparente
- **Të promovojnë brenda grupit të tyre Shqipërinë në mënyrë aktive si një treg kreditimi fitimprurës**
- **Të forcojnë në mënyrë aktive bilancet, nëpërmjet veprimeve vendimtare individuale dhe kolektive**
- **Të nxisin në mënyrë aktive rregullatorët dhe ligjvënësit për përmirësime të mëtejshme në sferën e kreditimit**





**BANK OF ALBANIA**

### **3. Përfundime**



### 3. Përfundime

- Perspektiva për rimëkëmbjen ekonomike është pozitive
- Megjithatë, ecuria e kreditimit mund të bëhet pengesë për rritjen afatmesme/afatgjatë
- Ndërsa kërkesa pritet të rritet, oferta e kredisë mbetet ende një çështje
- BSH-ja ka bërë përpjekje konkrete për rigjallërimin e rritjes së kredisë dhe plani për zgjidhjen e NPL-ve trajton një pjesë të madhe të problemeve që mbeten
- **Megjithatë, bankat tregtare nuk janë aktorë pasivë në skenën e stabilitetit ekonomik dhe financiar**
  - Bankat tregtare duhet të jenë më largpamëse dhe elastike në politikat e kreditimit
  - Produktet e kreditimit dhe ato bankare mund të përmirësohen
  - Rreziku i kredisë duhet të perceptohet si duhet, në linjë me perspektivat e situatës ekonomike
  - Duhet forcuar veprimet individuale dhe kolektive me qëllim përmirësimin e bilanceve dhe nxitjen e lobimit të efektshëm.

# Faleminderit për vëmendjen!